



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:093957

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05533559

P.nr.123/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit R. B. nga fsh. Sh., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve sipas nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.414/2024, të datës 21.03.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.414/2024, të datës 21.03.2024, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

R. B., nga i ati H., e ëma Z., mbiemri i vajzërisë P., i lindur me ..., në Sh. Komuna L., ku edhe tani banon, i gjendje së dobët ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S E P S E

Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 28.10.2023, në shtëpinë tij në Sh. Komuna Lipjan, i pandehuri me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka vjedhur energjinë elektrike duke e marr dhe shfrytëzuar pa autorizim nga KEDS si furnizues i autorizuar, në atë mënyrë që nga njëtori elektrik me numër DFE ... është shkyçur nga distanca nga KEDS, ndërsa më pas i pandehuri është lidhur direkt në rrjetin elektrik dhe në këtë mënyrë është furnizuar pa matje, ashtu që të dëmtuarës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, Sh. a - Distrikti në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 762.63 euro,

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve sipas nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 314 par.1 të KPRK-së, si dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **300.-€**, (treqindeuro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri që të dëmtuarës tija kompenzojë dënimin në shumë prej 762.63-€, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

DETYROHET i pandehuri në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, shumën prej 20-€, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.414/2024, të datës 21.03.2024 e ka akuzuar të pandehurin R. B. nga fsh. Sh., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve sipas nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehurit të shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën dhe provat që janë bashkangjitur kallëzimit penal, si procesverbali i vendshiqimit dt.19.03.2022, fatura e dëmit të shkaktuar dt.25.03.2022, fatura e kalkulimit të rikthimit të humbjeve dt.25.03.2022, foto e vendit të ngjarjes dt.19.03.2022, procesverbali i vendshiqimit dt.28.10.2023, fatura e dëmit të shkaktuar dt.30.10.2023, fatura e kalkulimit të rikthimit të humbjeve dt.30.10.2023, foto e vendit të ngjarjes dt.28.10.2023, procesverbali i vendshiqimit dt.17.12.2022, fatura e dëmit të shkaktuar dt.05.01.2023, foto e vendit të ngjarjes dt.28.10.2022, procesverbali i dt.28.10.2022, si dhe procesverbale tjera dhe shkresat e tjera mbi bazën e të cilave gjykata konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpall fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do të shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsytet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri parashihet dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe neni 450 të KPPK-së ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 462 të KPPK-së, pasi që ka prova në shkresat e lëndës të cilat e vërtetojnë lartësinë e dëmit të shkaktuar, andaj nga këto arsye gjykata e detyroj të pandehurin që palës së dëmtuar t'ia kompensojë dënimin e shkaktuar.

Nga arsytet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.123/24, me datën 02.04.2024

Numri i lëndës: 2024:093957
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05533559

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.